

[Këtu mund të gjeni listën e përhershme të renditjes së gjyqtarëve të gjykatave të Shkallës së parë dhe gjykatave të apelit në Republikën e Shqipërisë](#)

## **Programi i Transparencës**

**Programi i Transparencës për  
Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Regjistri për regjistrimin e  
kërkesave për të drejtën e  
informimit**

**Formulari tip "Kërkesë për  
Informacion"**

**Informacion per Kandidatet**

**Informacion për Publikun**

**Vendim Nr. 187, datë 03.02.2006**

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 147, të Ligjit Nr. 8811, datë 17.05.2001, Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9399, datë 12.05.2005, Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare, të Ligjit Nr. 8502, datë 30.06.1999, Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare, të Ligjit Nr. 8136, datë 31.07.1996, Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 8436, datë 28.12.1998, Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9110, datë 24.07.2003, Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda, në mbledhjen e tij të datës 03.02.2006,

**Këshilli i Lartë i Drejtësisë:**

1. Filloi procedurat e verifikimit të mandateve të dy anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare e datës 06.12.2005 dhe, pasi verifikoi zgjedhshmërinë, pajtueshmërinë dhe ushtrimin në përputhje me ligjin, të detyrës së anëtarit të

- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, konstatoi se, zgjedhja e gjyqtarit Hysni Demiraj si anëtar i këtij Këshilli është bërë në përputhje me ligjin ndërsa, shtyu verifikimin e mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për në mbledhjen e ardhshme të Këshillit, për gjyqtarin Artan Gjermëni.
2. Konstatoi dhe deklaroi mbarimin e mandatit si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Zonjës Shpresa Beçaj.
  3. Trajtoi problemin e drejtimit të disa gjykatave si pasojë e vakancës së krijuar nga zbatimi i Ligjit Nr. 9448, datë 05.12.2005, Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8811, datë 17.05.2001, Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe, në përfundim, vendosi :
    - a- të delegojë gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Shkodër, Zotin Fatmir Hoxha, për të kryer përkohësisht edhe detyrën e kryetarit të kësaj gjykate;
    - b- të delegojë gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Zotin Albert Meça, për të kryer përkohësisht edhe detyrën e kryetarit të kësaj gjykate;
    - c- të delegojë gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Zotin Andi Civici, për të kryer përkohësisht edhe detyrën e kryetarit të kësaj gjykate;
    - d- të delegojë gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Zotin Dritan Caka, për të kryer përkohësisht edhe detyrën e kryetarit të kësaj gjykate.
  4. Pasi shqyrtoi kërkesën e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për trajtimin e problemit të pushimeve vjetore për vitin 2005, për gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, vendosi që ai problem të zgjidhet si nëpërmjet lejeve, ashtu edhe duke iu drejtuar Këshillit të Ministrave për zgjidhjen financiare të tij.
  5. Trajtoi problemin e caktimit të një përfaqësuesi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në përbërje të Këshillit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare dhe vendosi të caktojë Zotin Aleksandër Muskaj, si anëtar në përbërje të Këshillit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
  6. Konstatoi suprimimin e vendit të punës së zëvendës drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 9414, datë 20.05.2005, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8136, datë 31.07.1996, Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë .
  7. Diskutoi dhe më pas miratoi kryerjen e analizave vjetore nëpër gjykata për vitin 2005, brenda muajit shkurt 2006 si dhe, caktoi të deleguarit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë nëpër këto gjykata.
  8. Shqyrtoi kërkesën për leje, për arësye shëndetësore, të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Arben Micko, dhe vendosi t'i japë leje për një vit.
  9. Shqyrtoi propozimet e Ministrit të Drejtësisë për delegime të gjyqtarëve dhe vendosi të bëjë delegimet përkatëse sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
  10. Pasi shqyrtoi kandidaturat për një vend vakant për gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, vendosi që t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda të Zonjës Albana Boksi.
  11. Pasi shqyrtoi kandidaturat për vendet vakante për dy gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, vendosi që t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda të Zonjës Iliriana Olldashi dhe të Zonjës Natasha Mulaj.

## **KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË**